

Përgjigje të pranuar:

7

Pozitive


2

Negative

9

Ende nuk kemi pranuar përgjigje

Numri i kërkesave të parashtruara për mbikëqyrje të jashtëzakonshme inspektuese
18




Njësitë rajonale të Inspektoratit Shtetëror të Punës, të cilëve u janë parashtruar kërkesa për mbikëqyrje të jashtëzakonshme inspektuese:

Shkup 15


Koçani 1

Shtip 1

Gjevgjeli 1




Subjekt/lëndë e mbikëqyrjes së jashtëzakonshme inspektuese ¹




¹ Në disa raste, kërkesat për mbikëqyrje të jashtëzakonshme inspektuese u referoheshin më shumë se një shkelje të së drejtës nga marrëdhënia e punës.

Koha e pritjes së përgjigjes ndaj një kërkesë për mbikëqyrje të jashtëzakonshme inspektuese


Periudha nga dorëzimi i kërkesës, deri në marrjen e përgjigjes nga ISHP-ja




Statusi i kërkesave për të cilat ende nuk ka përgjigje



Periudha nga dorëzimi i kërkesës, deri në marrjen e përgjigjes



Statusi i kërkesave për të cilat ende nuk ka përgjigje



PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

- Inspektorati Shtetëror i Punës ka përmirësuar efikasitetin sa i përket trajtimit dhe informimit për kërkesat për mbikëqyrje të jashtëzakonshme inspektuese. Numri i rasteve në të cilat ISHP-ja ka tejkalluar afatet ligjore për veprim është ulur me 35% krahasuar me periudhën e mëparshme të raportimit. Këtë tremujor, ISHP-ja ka tejkalluar afatin e fundit për veprim dhe informim në pesë nga 18 raste.
 - Inspektorati Shtetëror i Punës duhet të vazhdojë me praktikën e mirë të veprimit efikas, në mënyrë që të informojë me kohë parashtruesit mbi inspektimet e zhvilluara të jashtëzakonshme.
- Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut mban takime javore me Inspektoratin Shtetëror të Punës për të diskutuar gjendjen e të drejtave të punëtorëve gjatë kohës së pandemisë. Këto takime janë jashtëzakonisht të rëndësishme për raste urgjente individuale që i trajton ISHP-ja, pasi në këto takime adresohen drejtpërdrejt rastet kur të drejtat e punëtorëve janë rrezikuar në veçanti. Në të njëjtën kohë, në takimet diskutohet për politikat ekzistuese të trajtimit të krizës, si dhe nevojën e miratimit të masave dhe rekomandimeve të reja për mbrojtjen e punëtorëve.
 - Të vazhdohet bashkëpunimi i Inspektoratit Shtetëror të Punës me shoqatat e qytetarëve që komunikojnë drejtpërdrejt me punëtorët, prezantojnë nevojat e tyre dhe përfaqësojnë interesat e tyre.
 - ISHP-ja të mbetet i hapur ndaj propozimeve të shoqatave të qytetarëve për të përmirësuar punën e tyre dhe për të zbatuar rekomandimet në praktikë.
- Gjithsej 306 punëdhënës të cilët kanë marrë mbështetje financiare në vlerë prej 16.305.020 denarë, nuk e kanë përmbushur detyrimin për të paguar pagat e 992 të punësuarve për muajin dhjetor
 - Drejtoria e të Ardhurave Publike dhe Inspektorati Shtetëror i Punës të vazhdojnë bashkëpunimin, i cili kishte filluar në muajin dhjetor 2020, për zbatimin e kontrolleve të koordinuara të punëdhënësve që kanë abuzuar me mbështetjen financiare të shtetit
 - Informimi transparent dhe me kohë i publikut për kontrollet e zbatuara dhe të koordinuara dhe për rezultatet e arritura.
- Inspektorati Shtetëror i Punës iu përgjigj pozitivisht 50% të kërkesave për mbikëqyrje të jashtëzakonshme inspektuese në lidhje me regresin për pushim vjetor - K-15 për vitin 2020, kurse për rastet e tjera ende jemi në pritje të përgjigjeve. Sidoqoftë, në asnjë rast ISHP-ja nuk ka konstatuar parregullsi dhe nuk shqiptuar gjopa kundërvajtjeje për punëdhënësit që e kishin paguar regresin pas datës 31.12.2020.
 - Inspektorati Shtetëror i Punës të vazhdojë praktikën e kryerjes së mbikëqyrjeve për pagimin e regresit të pushimit vjetor - K-15 nga ana e punëdhënësve.
 - ISHP-ja të shfrytëzojë mundësinë për të shqiptuar gjopa kundërvajtjeje ndaj punëdhënësve që kanë paguar regresin e vitit 2020 pas datës 31.12.2020.
 - Inspektorati Shtetëror i Punës duhet të kërkojë një interpretim autentik të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive për sektorin privat në fushën e ekonomisë për mënyrën e llogaritjes dhe përcaktimit të shumës së regresit për pushim vjetor për punëdhënësit që kanë pasur vështirësi financiare dhe që kanë paguar më pak se minimumi prej 40 përqind të bazës për regres të pushimit vjetor.